



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Sesioni vjeshtor

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Mbledhja nr.21

Prishtinë, më 11.7.2018, me fillim në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit , salla N-303

PROCESVERBALI

Në mbledhje morën pjesë: Igor Simiq, kryetarë i Komisionit, Xhelal Sveçla dhe Danush Ademi, zëvendës kryetarë, Kujtim Shala, Fadil Beka, Haxhi Shala, Zoran Mojsilović, Jasmina Zhivković, Sasha Milosavljeviq, Rasim Selmanaj, Albert Kinolli, Mufera Sernica Shinik, Duda Balje, Slobodan Petroviq dhe Veton Berisha, anëtarë.

Pjesëmarrës tjerë: Senad Karaahmetović, (OEBS), Zijush Ahmeti, (KSZ) dhe Celal Iliaz, Drejtoria për medie dhe marrëdhënie me publikun.

Personeli për mbështetjen e Komisionit: Nataša Prica-Tišma dhe Drita Çarkaxhiu.

Mbledhjen e kryesoi: Igor Simić, kryetarë i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua:

Rend i ditës

1. **Miratimi i rendit të ditës**
2. **Shqyrtimi i projektligjit nr. 06/L-035 për veprimtarinë e shërbimit hidrometeorologjik me amendamentet e Komisionit funksional të Bujqësisë, Pylltarisë, ambientit dhe të Planifikimit Hapësinor**
3. **Shqyrtimi i projektligjit nr. 06/L-059 për Kompleksin Memorial „ Adem Jashari'' në Prekaz me amendamentet e Komisionit funksional të Bujqësisë, Pylltarisë, ambientit dhe të Planifikimit Hapësinor**
4. **Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-049 për Inovacionin Shkencor dhe Transferin e Dijes dhe të Teknologjisë me amendamentet e Komisionit Funksional të Arsimit, Shkencës, Teknologjisë, Kulturës, Rinisë, Sportit, Inovacionit dhe Ndërmarrësit**
5. **Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-022 për Ndërmarrjet Sociale me Amendamentet të Komisionit Funksional të Shëndetësisë, Punës dhe përkujdesjes Sociale.**

6. Rishqyrtimi i Planit të Punës për vitin 2018.
7. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës.

Kryetari, konstatoi se komisioni miratoi rendin e ditës, pa ndryshime.

2. **Shqyrtimi i projektligjit nr. 06/L-035 për veprimtarinë e shërbimit hidrometeorologjik me amendamentet e Komisionit funksional të Bujqësisë, Pylltarisë, Ambientit dhe të Planifikimit Hapësinor.**

Kryetari: Paraqiti për shqyrtim Projektligjin nr. 06/L-035 për veprimtarinë e shërbimit hidrometeorologjik dhe kërkoi nga anëtarët e komisionit të deklarohen nëse kanë ndonjë propozim apo sugjerim në raportin me amendamente të Komisionit Funksional.

Pasi nuk pati diskutime shtesë, Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, nxori këtë:

Rekomandim

P/ligji nr. 06/L-035 për veprimtarinë e shërbimit hidrometeorologjik me amendamentet e propozuara nga Komisioni Funksional nuk cenon dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve, dhe rekomandohet të procedohet për miratim në Kuvend.

3. **Shqyrtimi i projektligjit nr. 06/L-059 për Kompleksin Memorial „ Adem Jashari” në Prekaz me amendamentet e Komisionit funksional të Bujqësisë, Pylltarisë, ambientit dhe të Planifikimit Hapësinor.**

Kryetari: Paraqiti për shqyrtim Projektligjin nr. 06/L-059 për Kompleksin Memorial „ Adem Jashari” në Prekaz dhe kërkoi nga anëtarët e komisionit të deklarohen nëse kanë ndonjë propozim apo sugjerim në raportin me amendamente të Komisionit Funksional.

Duke pasur parasysh që nuk kishte diskutime përkitazi me projektligjin dhe pas rezultatit të votimit, Për:12, Kundër: 3 (Përfaqësuesit e GP-Lista Serbe të përfaqësuar në strukturën e Komisionit u deklaruan kundër miratimit të projektligjit dhe amendamentet e propozuara nga komisioni Funksional me konstatimin se i njëjtit shkelin dhe cenon të drejtat dhe interesat e Komunitetit Serb), Komisioni nxorri këtë:

Rekomandim

Me shumicën e votave Projektligji nr. 06/L-059 për Kompleksin Memorial „ Adem Jashari” në Prekaz dhe amendamentet e propozuara nga Komisioni Funksional nuk cenon dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve, dhe rekomandohet të procedohet për miratim në Kuvend.

4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-049 për Inovacionin Shkencor dhe Transferin e Dijes dhe të Teknologjisë me amendamentet e Komisionit FunkSIONAL të Arsimit, Shkencës, Teknologjisë, Kulturës, Rinisë, Sportit, Inovacionit dhe Ndërmarrësi.

Kryetari: Pparaqiti për shqyrtim Projektligjin nr. 06/L-049 për Inovacionin Shkencor dhe Transferin e Dijes dhe të Teknologjisë dhe kërkoi nga anëtarët e komisionit të deklarohen nëse kanë ndonjë propozim apo sugjerim në raportin me amendamente të Komisionit FunkSIONAL.

Pas shqyrtimit të Projektligjit dhe Raportit me amendamente të Komisionit FunkSIONAL, Komisioni nxori këtë:

Rekomandim

Projektligjit nr. 06/L-049 për Inovacionin Shkencor dhe Transferin e Dijes dhe të Teknologjisë me amendamentet e propozuara nga Komisioni FunkSIONAL nuk cenon dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve, dhe rekomandohet të procedohet për miratim në Kuvend..

5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-022 për Ndërmarrjet Sociale me amendamentet e Komisionit FunkSIONAL për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale.

Kryetari: Paraqiti për shqyrtim Projektligjin nr. 06/L-022 për Ndërmarrjet Sociale dhe kërkoi nga anëtarët e komisionit të deklarohen nëse kanë ndonjë propozim apo sugjerim në raportin me amendamente të Komisionit FunkSIONAL.

Pas shqyrtimit të Projektligjit dhe Raportit me amendamente të Komisionit FunkSIONAL, Komisioni nxori këtë:

Rekomandim

Projektligji nr. 06/L-022 për Ndërmarrjet Sociale me amendamentet e propozuara nga Komisioni FunkSIONAL nuk cenon dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve, dhe rekomandohet të procedohet për miratim në Kuvend..

6. Rishqyrtimi i Planit të Punës për vitin 2018

Igor Simić: në përputhje me parimet e përgjithshme të punës, kërkesave dhe nevojave të Komisionit në mënyrë periodike rishqyrton planin e vet të punës. Në mbledhjet e para, Komisioni ka hartuar planin e punës në bazë të të cilit ka zhvilluar aktivitetet e saja, dhe kjo shihet në bazë të mbledhjeve të mbajtura, hartimi irekomandimeve për Kuvendin, përkritazi me shqyrtimin e projektligjeve si objektiva kryesore si dhe raportet e komisioneve funksionale ne aspektin e të drejtave dhe të interesave të komuniteteve. Gjatë punës së sajë, Komisioni ka zbatuar procedurat në përputhje me Rregulloren e punës së Kuvendit.

Çështjet të cilat nuk janë arrit të realizohen në gjysmë vjetorin e parë të vitit, janë vizitat në terren në Kuvendet komunale, me arye se në këtë periudhë kanë qenë zgjedhjet lokale dhe nuk janë formuar organet komunale, pastaj periudha e mbajtjes së rrethit të dytë të zgjedhjeve, si dhe një sërë aktivitete tjera të cilat i kemi pasur në Kuvend.

Me qëllim të zbatimit të planit për periudhën e ardhshme është esenciale që të përcaktohen Kuvendet Komunale, të caktohen terminet kohore për realizimin e aktiviteteve të vizitave në terren. Ajo që është risi, është zgjerimi i strukturës së Komisionit tonë, me tre anëtarë të ri të Komisionit nga radha e komunitetit shumicë dhe rrada e komunitetit pakicë.

Ai theksoi se procesi i mbikëqyrjes së implementimit të Ligjit për Vetëqverisje Lokale dhe Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal nga ana e Komisionit do të jetë njëra nga detyrat kyçe, në të cilat do të bazohet në periudhën e ardhshme.

Kryetari iu dha fjalën anëtarëve të komisionit që të paraqesin propozimet e tyre me qëllim që të plotësohet ose ndryshohet plani i punës.

Slobodan Petrović: Plani i punës së Komisionit është udhërrëfyes për aktivitetet e komisionit, dhe në këtë vështrim mundëson funksionimin më të mirë të tij.

Në kuadër të këtij plani, propozoi që të përfshihet raportimi i ministrave nga rrada e komunitetit pakicë, si dhe Drejtori i zyrës për çështje të komuniteteve pran Zyrës së Kryeministisë, për tu shqyrtuar çështjet e caktuara nga fusha e veprimtarisë dhe përgjegjësive të saja.

Albert Kinolli: Propozoi që në periudhën e ardhshme të aktiviteteve të Komisionit, të përsëritet ftesa në formë zyrtare për Komisionarin e gjuhëve, Slavisha Mladenoviçin, përkitazi të raportojë lidhur me gjendjen e zbatimit të Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve.

Pas këtyre diskutimeve të gjithanshme, Komisioni nxjerrë këtë:

Përfundim

Ngarkohet administrata për mbështetje të Komisionit që në planin e punës të inkorporojë propozimet e miratuar të deputetit Slobodan Petroviç dhe Albert Kinolli.

Mbledhja ka përfunduar në orën 11:40.

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit.

Kryetarë i Komisionit,

Igor Simiq